


D  
O  
K  
U  
M  
E  
N  
T  
I  
M



TIRANË

GODINAT INDUSTRIALE

1945-1990

# HYRJE 6-9FQ

---

PERIODIZIMI 10-11FQ

HARTA 12-13FQ

GALERIA 14-29FQ, 289-295 FQ

**1** 30-57FQ NJESIA ADMINISTRATIVE NR.1

UZINA AUTOTRAKTORI "ENVER"  
POLIGRAFIKU

**3** 76-107 FQ NJESIA ADMINISTRATIVE NR.4

UZINA E ANTIBIOTIKUT  
N.SH.N RRUGA-URA  
REPARTI I LARJES SE SIXHADEVE  
UZINA ELEKTROMJEKSORE  
PARKU I GJEOLOGJISE, OFICINA  
D.A.N- OFICINA E AUTOMJETEVE TE NDERTIMIT

**5** 176-215 FQ NJESIA ADMINISTRATIVE NR.7

UZINA "ENVER"  
STABILIMENTI "MIHAL DURI"

**2** 58-75FQ NJESIA ADMINISTRATIVE NR.3

FABRIKA PORCELANI  
FABRIKA E LLULLAVE

**4** 108-175 FQ NJESIA ADMINISTRATIVE NR.6

KOMBINATI I TEKSTILEVE "STALIN"  
TEC-I I KOMBINATIT  
FABRIKA E QELQIT  
KOMBINATI USHQIMOR "ALI KELMENDI"  
KOMBINATI "MISTO MAME"

**6** 216- 245 FQ NJESIA ADMINISTRATIVE NR.8

UZINA "DAJTI"  
UZINA "DINAMO"

7

246-263 FQ

NJESIA ADMINISTRATIVE NR.9

UZINA E MEKANIKES BUJQESORE  
PARKU AUTOMOBILISTIK I UDHETAREVE


8

264-289 FQ

NJESIA ADMINISTRATIVE NR.11

KOMBINATI "JOSIF PASHKO"  
UZINA "PARTIZANI"

P E R M B A J T J E




## HYRJE

Godinat dhe komplekset industriale u ndërtuan përgjatë viteve duke u zgjeruar dhe përshtatur me linjat e prodhimit, nevojat e tregut si dhe me teknologjitë në ndryshim të industrisë. Në planet rregulluese të Tiranës nga vitet 1940-1943 si dhe ato të viteve 1958 dhe 1989 janë perçkatuar zonat funksionale ndër to dhe ato industriale. Këto komplekse të prodhimit të ndërtuara në Shqipëri kryesisht gjatë viteve 1945-1990 kanë patur një rol të veçantë dhe shumë të rëndësishëm në formësimin urban dhe arkitektonik të zonës së cilës i përkisnin. Volumet masive, rrugët e transportit, peisazhi industrial në tërësi krijonin jo vetëm fizionominë e zonës në kontekstin urban, por dhe në atë social.

Ndërtesa industriale planifikohej dhe ndërtohej si një *"fenomen urban"* i cili kishte rëndësinë vizuale dhe natyreshëm i ndërtuar dhe rrethuar nga njerëzit.

Qendrat e rëndësishme industriale-urbane dominonin vizualisht jo vetëm zonën së cilës i përkisnin, por ishin pika referimi dhe nyje të fuqishme të zhvillimit të qytetit. Në fjalorin e komunikimit të përditshëm zonat e qytetit emërtoheshin sipas objekteve industriale, siç njihen në qytetin e Tiranës *"Zona e oxhakut"*, *"21 Dhjetori"*, *"Zona e kombinatit"*, etj. terminologji që vazhdojnë të përdoren edhe sot, pavarësisht se *"lavdia"* e epokës industriale të viteve 1945-1990 tashmë ka përfunduar.

Zonat të cilat fitonin këtë status në qytet nuk ishin thjesht



lagje, por ato ishin një histori. Autori Luigi Za, në librin e tij “Storia e vita quotidiana di un quartiere simbolo di Tirana”, e përshkruan kështu statusin e zonës së Kombinatit të Tekstileve “Stalin”:

*“Kombinati më shumë se një lagje është një histori. Jo të gjitha lagjet, përfshirë dhe ato të Tiranës, kanë diçka për të treguar ose dinë se si ta tregojnë. Disa prej tyre humbasin në anonimatin e kohës, pa gjurmë e pa lavdi, të tjera belbëzojnë për të lënë shënja të përkohëshme të ekzistencës; disa janë bërë vetëm nga vrima të memories, shprehje të thjeshta urbane, e të tjera prehen rreth qendrës, por pa identitet. Kombinati, përkundrazi, ka të gjithë përbërësit për një tregimtari të madhe: fillimet, personazhet, heronjtë, konfliktet, komplotet, veprimtaritë dhe konkluzionet. E gjitha kjo në një hapësirë dhe vendodhje të mirëpërcaktuar, lehtësisht të dallueshme dhe të përshkrueshme.”*


Duke e lexuar si të tillë rolin e zonave industriale në hapësirën urbane, sociale, kulturore dhe historike të qytetit, si dhe duke e konsideruar arkitekturën si një proces transformimi dhe konvertimi të vazhdueshëm të ndërtesave në përgjigje të ndryshimeve të kohës së cilës i përkasin, autorët e këtij botimi synojnë të dokumentojnë godinat industriale të qytetit të Tiranës të trashëguara nga periudha e industrializimit socialist.


Godinat industriale, më shumë se asnjë tipologji tjetër ndërtimore, e kanë pjesë të tyre integrale procesin e transformimit. Ato shpesh i kanë patur fillesat e tyre si objekte

të vogla të cilat janë zgjeruar, transformuar, ripërshtatur dhe zhvilluar ndër vite. Sot këto ndërtesa po i nështrohen fenomeneve të reja. Zonat e pastra industriale, dikur periferike të largëta, janë tashmë pjesë integrale e zonave të banimit të transformuara nga proceset e evoluimit të qytetit. Një pjesë e këtyre godinave është privatizuar dhe shpesh i gjejmë të ripërshtatura me funksione të reja pa asnjë analizë dhe respekt ndaj ekzistueses, disa nuk figurojnë më në hartën e qytetit apo një pjesë është lënë në harresë.

Si dëshmitarë *“gjigandë”*, tashmë të heshtur, të epokës së industrializimit socialist këto ndërtime nuk meritojnë, indiferentizmin, degradimin apo zhdukjen nga struktura dhe peisazhi urban i qytetit. Ndaj tyre duhet të mbahet një qëndrim i qartë, i cili vjen pas analizave për të kuptuar se çfarë duhet ruajtur, si duhen transformuar dhe konvertuar dhe kush plotëson kriteret për të fituar statusin e objektit të trashëgimisë industriale.

Nisur nga ky reallitet, DOKUMENTIMI i realizuar nëpërmjet këtij botimi synon të bëhet një instrument hulumtues për të nxjerrë në dritë arkitekturën e godinave industriale në qytetin e Tiranës. Gjithashtu ky material është një përpjekje për të krijuar një bazë të dokumentuar, e cila do të shërbejë për të kryer analiza të thelluara të tipologjisë së godinave industriale, të planifikimit të këtyre territoreve, teknologjive dhe materialeve të ndërtimit, historisë së tyre dhe impakteve socio-ekonomike në shoqëri, dhe padyshim për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj tyre.






VENDNDODHJA E GODINAVE INDUSTRIALE  
NË TIRANË



1.




6.




2.



3.



4.



阿尔巴尼亚人民共和国  
工业矿产部  
冶金联合企业乌敏图

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E INDUSTRIE DHE MINIERË  
PËNJËZË AGRORË E KOMBINATIT

5.